



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE PROJEKTEVE**  
**SEKTORI I PROJEKTEVE DHE SHËRBIMEVE INXHINIERIKE**

Elbasan më    -/    -/ 2019

**RELACION TEKNIK I PROJEKT - ZBATIMIT TË OBJEKTIT**  
**“RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS "ALI ÇAUSHI" DHE SHESHET E**  
**PALLATEVE 108/3; 108/4; 108/5; 108/6; 108/7; 108/8; 108/9; 108/10; 108/11;**  
**108/12"**

## **I. TË PËRGJITHSHME**

### **1. HYRJE**

Në kuadrin zhvillimeve urbane të qytetit nevoja për përmiresimin e rrjetit urban nëpërmjet investimeve në infrastrukturë është një kërkesë imperative.

Rëndësia e këtij investimi qëndron në faktin se duke realizuar rikonstrukcionin e këtij segmenti dhe rikonstrukcioni i shesheve të pallateve do të përmirësohet në mënyrë të ndjeshme qarkullimi i automjeteve dhe përdoruesve të rrugës duke lehtësuar në këte mënyrë lëvizjen e banorëve.

### **2. OBJEKTI I RELACIONIT**

Mbështetur në detyrën e projektimit dhe kërkesat e Bashkisë Elbasan objekti i këtij relacioni teknik është paraqitja e projekt zbatimit të kryer nga inxhinierët ku prezantohen masat e nevojshme inxhinierike që janë parashikuar në projekt për elementë të ndryshëm të veprës si shtresat rrugore, disiplinimi i ujrave, të dhënat për topografinë e ambjentin, gjeologjinë e hidrologjinë, sinjalistikën etj.

### 3. GJENDJA EKZISTUESE DHE ANALIZA E SAJ

Rruga "Ali Çausi" dhe sheshet e pallateve ndodhen në lagjen "Syrja Dylgjeri", Njësia Administrative nr. 3.




Fig 1. Vendndodhja

Segmenti rrugor që studiohet në këtë projekt fillon nga kryqëzimi me rrugën " Qemal Stafa" në veri deri në kryqëzimin me unazën " Zogu I" në jug dhe ka një gjatësi prej 449 ml.



Fig 2. Fillimi i rrugës



Fig 3. Mbarimi i rrugës

Rruga "Ali Çausi" gjatë gjithë gjatësisë së saj lidh sheshet e pallateve. Sheshet e pallateve ndodhen në gjendje natyrale, ku paketat e shtresave rrugore mungojnë. Fotografite e mëposhtme tregojnë një pasqyrim të plotë të gjëndjes ekzistuese.



*Fig 3. Sheshi para pallatit 108/3*



*Fig 4. Sheshi para pallatit 108/4 dhe 108/5*



*Fig 5. Sheshi para pallatit 108/8 dhe 108/9*



*Fig 6. Sheshi para pallatit 108/7 dhe 108/8*



*Fig 7. Sheshi para pallatit 108/6 dhe 108/7*



*Fig 8. Sheshi para pallatit 108/6*



*Fig 9. Sheshi përbri pallatit 108/10*



*Fig 10. Sheshi para pallatit 108/10*



*Fig 11. Sheshi para pallatit 108/11 dhe 108/12*



*Fig 12. Sheshi para pallatit 108/12*

Rruga "Ali Çausi" paraqitet pjesërisht e dëmtuar dhe përgjatë gjithë gjatësisë së saj shoqërohet me gropa. Rruga përgjatë gjithë gjatësisë së saj është e konturuar nga bordurat e parapërgatitura. Trotualet janë pjesërisht të pranishme në rrugë. Në këtë segment rrugor ka mungesë të sistemimit të ujërave të bardha, gjelbërimit, sinjalistikës. Rrjeti i ndriçimit ekziston në anën jugore ku lind nevoja të bëhet rrjet ndriçimi i ri me parametrat bashkëkohorë.



*Fig 13. Fillimi i rrugës ekzistuese*



*Fig 14. Segment i rrugës ekzistuese*



Fig 15. Segment i rrugës ekzistuese



Fig 16. Segment i rrugës ekzistues

Gjeresia e rruges do te jetë ajo e rrugës ekzistuese duke ruajtur gjerësitë e trupit te rrugës. trotuaret në këtë segment do të sistemohen dhe do të vihen në funksion të sistemit të shesheve të pallateve. Hapsirat e gjelberta nuk ekzistojne në këtë fazë.

dhe e hapsirave te gjelberta eshte shume e kufizuar. Aktualisht infrastruktura rrugore perben problem ne jeten e banoreve te lagjes sidomos ne periudhen e shirave, pasi sheshet ndërmjet pallateve si dhe gropat e rruges mbushen me uje.

Ndërhyrja në këtë bllok banimi bëhet e domosdoshme për shkak të gjendjes ekzistuese e cila ka dëmtim të shtresave asfaltike si dhe prani te gropave pothuajse në të gjithë gjatësinë e saj.

Në këtë segment rrugor ka prani të trotuareve vetëm ne fillim të rrugës. Rruga është konturuar nga muret rrethues të shtëpive private dhe nga objekte banimi shumë katëshe. Planimetria e rrugës paraqitet përgjithësisht vijëdrejte.

#### 4. MASAT INXHINIERIKE QË PARASHIKOHEN NË PROJEKT

Specialisti i Sektorit të Projektimit dhe Shërbimeve Inxhinierike duke u bazuar në kërkesat e detyrës së projektimit, kushtet teknike të projektimit KTP në fuqi, gjendjes egzistuese të rruges, rekomandimeve të studimit Gjeologo – inxhinierik dhe Hidrogeologjike dhe fondit të vënë ne dispozicion përpiloi masat për rikonstruksionin e plotë te rrugës si më poshtë :

##### 4.1 Planimetria

Gjatë fazës së hartimit të projektit, një nga çështjet kryesore, që është mbajtur në konsiderate, ka qenë pershtatja e rruges së re me gjendjen e rrugës ekzistuese pa cënuar cilësinë. Në paketën e shtresave janë marrë parasysh të gjithë faktorët që nevojiten për llogaritjen e tyre të tilla si trafiku i pritshëm, klima, bazamenti, etj

Pjesa e asfaltuar e rrugës ka nevojë për rikonstruksion dhe do të ketë gjerësi të trupit të rrugës ekzistuese me gjatësi 265 ml, me gjerësi 3.5 m deri në 4.5 m (duke ruajtur rrugën ekzistuese), kurse pjesa tjetër do te trajtohet si sheshe funksionale të këtyre pallateve duke respektuar gjerësitë ekzistuese pa ndërhyrë në pronë private.

Pjeset e shesheve do të trajtohen me shtresa betoni + pllaka betoni 8 cm. Në pjeset e trotuareve të pallateve do të ruhen kuotat e këtyre trotuarave dhe sheshet funksionale do të jenë 12 cm deri në 17 cm disnivel më poshtë. Trotuari i pallateve me sheshet do të lidhen ndërmjet tyre me kunete beton – arme me të njëjtën armim që do të ketë edhe pista e betonit me dopjo zgare me hekur  $\Phi$  6m/m çdo 20 cm. Kunetat do të jenë në të dy krahet 2 x 0.4m dhe do të jetë kuneta e shtruar me pllaka.

Sheshet dhe rruga duhet të ketë pjerresi tërthore me pjerrësi të dyanëshme me 2.5%, kurse pjerrësia tërthore e kuneës duhet të jetë 10 %.

Rruga që do të rikonstruktohet e cila ka një gjatësi totale 449 m do të ketë gjerësi të trupit të rrugës do të jetë ai ekzistues duke ruajtur parametrat për vendshkëmbime dhe për lëvizjen normale të banorëve të këtij blloku banimi. Pjesa kaluese e rrugës do të trajtohet me shtresat

- stabilizant 10cm
- binder 6cm
- asfaltobeton 4cm

Sheshet ndërmjet pallateve do të trajtohen në dy forma :


- hapësirat e gjelbërta që do të jenë për ambjentet clodhëse
- hapsirat për parkim makinash dhe e qarkullimit të mjeteve.

Në hapsirat për parkim makinash dhe e qarkullimit të mjeteve do të trajtohen shtresat


- zhavor 20 cm
- betonarme 15cm
- pllaka betonele 8cm + 2cm rërë

Kjo rrugë është projektuar me profilat tërthore tip si më poshtë:

Profili tërthor i sheshit tip1




## Profili tërthor i rrugës tip 1



### • Trotuarët

Parashikohet që gjerësia trotuarit është variabël në të dy anët e rrugës, dhe pjerrësia tërthore e tij është 1 % .

Për ndërtimin e tij kemi parashikuar këto shtresa:



Në fillimet dhe fundet e çdo segmenti, si dhe në vendet e kalimit të këmbësorë në rrugë, trotuari do të ndërtohet i ulur, për të bërë të mundur, lëvizjen lirshëm për njerëzit me aftësi të kufizuar, karrocave të fëmijeve etj.

Gjatë realizimit të shtresave, detyrimisht të respektohet cilësia e materialeve dhe kërkesat për kompaktësim, në përputhje me specifikimet teknike.

- **Bordurat dhe kunetat**

Trupi i rrugës do të kufizohet me bordurë betoni të parapërgatitura me përmasa 20x35cm ekzistuese. Sheshi do të ketë bordura monolite betoni C25/30 me përmasa 20x30cm si në projekt. Bordurat e sheshit do të vendosen mbi shtresat bazë të sheshit. Bordurat që do të përdoren në rakordimet e rrugës "Ali Çaushi" me sheshet e pallateve, do të prodhohen të parapërgatitura sipas rrezeve të dhëna në projekt.

Kunetat do të jenë me gjerësi  $b = 40\text{cm}$ , kunetas betoni për rrugën dhe kuneta me pllaka për sheshin. Në trotuare, pranë kryqëzimeve, në vendet e kalimit të këmbësorëve janë parashikuar pandus.

## **5. INFRASTRUKTURA RRUGORE**

- **Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza**

Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza egziston dhe funksionon si linjë e ujrave mikse ku ujjat e bardha të rrugëve që janë rikonstruktuar shkarkojnë në pusët e ujrave të zeza dhe nuk kanë nevojë për ndërhyrje. Do të jetë e nevojshme rregullimi i kokave të pusëve me qëllim që të lëvizin kuotat e rrugës dhe sheshit, duke vendosur pllaka beton/arme + kapak gize sipas detajit të dhënë në projekt (me zërin e riparimit pusësh parashikohet heqja e kapakut ekzistues, riparimi i pusët deri në kuotën e duhur, vendosja e bazamentit beton/arme + kapak gize.)

- **Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të bardha**

Në të gjithë gjatësinë e rrugës do të ndërtohet sistemi i kullimit të ujrave të shiut. Ai do të përbëhet nga kunetat të vendosura në një anë të rrugës. Kunetat do të kenë gjerësi 0.4m dhe pjerresë tërthore 10%. Kunetat i shkarkojnë prurjet e tyre në tubat e brinjëzuar dhe betoni Ø200 siç tregohet në projekt. Do të ndërtohen pusët shimbledhës me zgara gize me përmasa 50x70cm.

- **Rrjeti i ujësjes**

Rrjeti i ujësjes ekziston dhe për rikonstrukcionin e tij do të investojë ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Elbasan.

- **Rrjeti i ndricimit**

Linja e re ndricimit do të bëhet në anën lindore të rrugës.

Realizimi i rrjetit të ri të ndricimit do të bëhet me shtylla xingato me një krah dhe me lartësi  $h = 7\text{m}$  dhe gjatësi krah  $l = 1.5\text{m}$ . Në të gjitha shtyllat tokezojnë me elektroda xingato  $h = 1.5\text{m}$  dhe me fijen e pestë të tokezimit. Në të gjitha shtyllat vendosen pusët plastike me kapak metalik 40x40x40. Thellessia e e shtrirjes së kabllit është  $h = -0.7\text{m}$  dhe në të gjitha lidhjet elektrike realizohen në morseten e shtylles dhe me kablllo 3x16mm<sup>2</sup> nga gabina, dhe 4x10mm<sup>2</sup> nga njëra shtylla tek tjetra, 4x1.5mm<sup>2</sup> do të jete nga bazamenti i shtylles deri në ndricuesi. Distanca

ndermjet shtyllave është rreth 25 m si në planimetri e shtyllave për të cilat kjo distancë respektohet. Shtyllat e rrugës furnizohen nga kabina “Kabina Arat e Gjata.” me kuader elektrik me fotoelement. Në kuader vendoset 1 automat 40A dhe 1 leshues 40A. Ndricimet janë të tipit IP65 250Ë i verdhë. Shtyllat të lyhen me varak dhe të montohen.

- **Rrjeti i telekomunikacionit**

Nga ana jone me ane të një kërkesë është kërkuar Albtelecom të na pajisë me të dhëna të detajuara mbi gjendjen aktuale të rrjetit ekzistues të linjave telefonike. Nga ana e Albtelecom është bërë azhurnimi i gjendjes ekzistuese të rrjetit dhe na është dhënë një kopje e planimetrisë në shkallën 1-1000 të këtij rrjeti.

Në kemi shtuar për operatore të tjera dhe për internetin për nevojat e bashkisë një linjë tubacioni plastike Ø 110 mm për zhvillimin perspektiv të zonës

- **Sinjalistika rrugore**

Në rrugën e re nuk ekziston asnjë lloj sinjalistike kështu që ajo do të bëhet e re që nga tabelat e deri tek vijëzimet.

## **6 . LLOGARITJA E SHITESAVE RRUGORE**

Koncepti i rrugës konsiston që shtresa e sipërme të jetë me pllakë rate 8 cm. Për rrjedhojë poshtë shtresës së pllakave vijën me rrathë 2 cm shtresë rëre, 15 cm beton sipas manualit, shtresë zhavori 20cm dhe tabani natyral.

### **SHTRESAT RRUGORE**

Dimensionimi i shtresave dhe verifikimi i tyre është bazuar në

### **MODELLO DI CATALOGO DELLE PAVIMENTAZIONI STRADALI**

L. Domenichini, P. Di Mascio  
P. Giannattasio, C. Caliendo, B. Festa  
A. Marchionna, P. Finni, E. Molinaro, G. Paoloni

Karakteristikat paraprake bazë janë:

Trafiku në jetëgjatësinë 15-20 vjeçare të rrugës

Ulja elastike e lejuar 0.51 mm

Automjeti njësi është automjeti me ngarkesë në aksin e mbrapëm 81.6 kN ngarkesë boshtore.

Shtresat e reja me beton dimensionohen në bazë të teorisë së elasticitetit me deformim elastik të lejuar nën rrotën e automobilit që dimensionohet.

Të dhëna të tjera bazë për projektimin e shtresave rrugore janë:

1. Ngarkesa e trafikut me akse standart për jetëgjatësinë 20 vjeçare të veprës:  $\dot{E}_{18} = 3 \text{ deri } 5 \times 10^6 \text{ ESAL}$  (mjete njësi standart 81.6 kN për aks)
2. Besueshmëria: **95%**
3. Devijimi i përgjithshëm standart  $S_0 = 0.44$
4. Moduli resilient i tabaneve (duke marrë parasysh rastet më të disfavorshme  $M_r = 35 \text{ Mpa}$ )
5. Humbja e shërbimit të projektimit  $\Delta PSI = 2$

Trafiku konsiderohet “i mesëm”:  $3\text{-}5 \times 10^6$  AADT në jetëgjatësinë 15-20 vjeçare të rrugës;

Trafiku llogaritet i korespondon një trafiku deri 500 aut njësi/24 orë, përcaktuar në “Raportin Teknik të Studimit të Trafikut të Rrugëve” (v.2005). Në dimensionimin e shtresave rrugore merren në konsideratë materialet rrethore si dhe kushte të tjera gjeologjike, hidrologjike dhe klimatike

Kompozimi i mëtejshëm i shtresave të sheshit (bashkelidhur janë paraqitur llogaritjet) mendohet të jetë:

#### ***Themeli dhe nënthemeli i sheshit (base and subbase)***

Këto janë projektuar me këtë përbërje:

##### *shtresa në mbushje:*

***Paketa e mbushjes***      Paketa e mbushjes:

⇒ 20 cm zhavor

##### *shtresa e përdorimit:*

***Paketa e përdorimit***      Paketa e përdorimit, ka këtë përbërje:

- ⇒ 15 cm shtrese b/a me zgara  $\Phi$  6 mm ne te dy krahët çdo 20 cm lart dhe posht
- ⇒ 2 cm rëre për krijimin e jastekut per vendosjen e pllakave
- ⇒ Pllaka betonele rezistente per auto  $t=8$  cm

Gjithsej paketa e perdorimit është parashikuar 25 cm, gjë që garanton jetëgjatësinë dhe fortësinë e tyre për një trafik të cilësuar “të mesme” të rrugës së ardhshme.

Kompozimi i mëtejshëm i shtresave të rrugës (bashkelidhur janë paraqitur llogaritjet) mendohet të jetë:

### ***Themeli dhe nenthemeli i sheshit (base and subbase)***

Këto janë projektuar me këtë përbërje:

#### **shtresa në mbushje:**

***Paketa e mbushjes***      Paketa e mbushjes:

- ⇒ shtresat ekzistuese

#### **shtresa e përdorimit:**

***Paketa e përdorimit***      Paketa e përdorimit, ka këtë përbërje:

- ⇒ 10 cm shtresë stabilizant
- ⇒ 4 cm shtresë binder
- ⇒ 6 cm shtresë asfaltobeton

Gjithsej paketa e perdorimit është parashikuar 20 cm, gjë që garanton jetëgjatësinë dhe fortësinë e tyre për një trafik të cilësuar “të mesme” të rrugës së ardhshme.

## **7 . HEQJA E VIJËS SË PROJEKTIT**

Në heqjen e vijës së projektit është marrë parasysh kuota e pjesës egzistuese të rrugës dhe relievi i terrenit. Gjithashtu në heqjen e vijës së projektit janë marrë parasysh dhe kuotat e bordurave në mënyrë që të nivelohen në lartësi të pranueshme si nga kembesoret ashtu dhe nga lartësia e nevojshme për kullimin e ujrave, janë marrë parasysh dhe kuotat e shtëpive që ndodhen përgjatë segmentit që do të trajtohet

Në pëfundim objekti është projektuar brenda kushteve teknike të projektimit duke pasur parasysh tonazhin e automjeteve që do të qarkullojnë, intesitetin e qarkullimit, formacioni e tokës si dhe materialet që do të përdoren.

**SHENIM** : Para fillimit të punimeve firma fituese e tenderi duhet të konsultohet me ndërmarrjet Ujësjelles Kanalizime , OSSH , Albatelekomit për thellësinë e vendosjes së linjave përkatëse dhe pozicionin e tyre pavarësisht projektit azhurnues të dhënë nga to .

*Linjat e telekomunikacionit janë aktualisht të vendosura 30 ~ 40 cm nën toke dhe linjat e objekteve të tjera deri në 70 cm nën tokë.*

*Në rast të dëmtimit të linjave të mësipërme nga firma zbatuese përgjegjësia do të bjere mbi firmën.*

*Punoi: Ing. Arian Baku*

*Përgjegjës i SPSHI- së*

*ark. Marvis Avllazagaj*

*Drejtor i DPTP- së*

*ark. Raimond Hazballa*

**MIRATOI**

**KRYETARI BASHKISË**

---

**QAZIM SEJDINI**



**Bashkia Elbasan**

## **RELACION TEKNIK I PROJEKT - ZBATIMIT TË OBJEKTIT**

**“RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS "ALI ÇAUSHI”DHE  
SHESHET E PALLATEVE 108/3; 108/4; 108/5; 108/6; 108/7; 108/8;  
108/9; 108/10; 108/11; 108/12”**

**Lagjja "SYRJA DYLGJERI"**

## Relacion Teknik

"RRUGA "ALI ÇAUSHI " DHE SHESHET E PALLATEVE

108/3, 108/4, 108/5, 108/6, 108/7, 108/8, 108/9, 108/10, 108/11,108/12

Rrjeti i ri i ndricimit do te behet si ne projekt .

Realizimi i rrjetit te ri te ndricimit do te behet me

Ndricues rrugor sodium 250w me shtylle metalike celiku

me lartesi  $h=7m$ , krahu  $l=1.5m$ . Te gjitha shtyllat tokezohen me elektroda

xingato  $h=1.5m$  dhe me fijen e peste te tokezimit. Ne te gjitha shtyllat

vendosen ,

puseta plastike me kapak ric te forte 40x40x40. Thellesia e shtrirjes se

kabllit eshte  $h=-0.8m$  dhe te gjitha lidhjet rrjetit elektrike realizohen ne

morseten e shtylles.Funizimi me energji nga nje shtylle ne tjetren do

vendoset kabllo 4x10mm<sup>2</sup>, nga rruga deri te ndricuesi funizimi do te behet

me kabell 4x16mm<sup>2</sup>. Me tel.4x1.5mm<sup>2</sup> do te jete nga bazamenti i shtylles

deri te ndricuesi. Distanca ndermjet shtyllave eshte 25m,dhe si pas projektit

si ne planimetri te gjitha shtyllat do te,furnizohen nga Gabina elektrike.

. Ndricimet jane te tipit Sodium 250w

Ne rrugen Rruga ALI ÇAUSHI " DHE SHESHET E PALLATEVE

” Jane vendosur puseta elektrike 40x40x40 te tension 380V ,qe vjen nga

gabina boks,qe do te funizohen

(Nr Analizes 3.44/1) **Germim dheu me eskavator me zinxhire me kove**

**0.25m<sup>3</sup> per kanale me gjeresi deri 2m toke e zakonshme kategoria III**

**me shkarkim ne mjet (linjat lidhese dhe PUB)** do te konsistoje ne :

Germimin e seksionit te detyruar per te krijuar hapesiren e nevojshme te

kanalit brenda te cilit do te montohen linjat e reja te ujrave te shiut PUB. Ne

projekt jane dhene detaje te seksionit te germimit ne faqe te posacme. Pas

germimit dherat te shkarkohen deri ne mjet.

-(Nr Analizes 3/An 55) **F.V pusete elektrike kontrolli pvc kapak te**

**forte RIC 1084+1086** do te konsistoje ne : Blerjen e pusetave dhe fiksimin

e tyre me beton ne objekt.

-(Nr Analizes 3.An/et) **F.V elektroda tokezimi profil xingato Cu**

do te konsistoje ne : Blerjen e elektrodave te tokezimit dhe morsetave

perkatese dhe mgulja e montimi i tyre ne objekt.

-(Nr Analizes 3.An/53) **F.V shtylle metalike per ndricim,H=7M,**

**d=160 mm** do te konsistoje ne : Blerjen e shtylles dhe montimin e saj ne

vendet perkatese.

-(Nr Analizes 4.133/3.7) **F.V.ne mure e konstruksione kabllo Al fuqie**

**+1000v, me izolim gome e mbulese plastmasi, i armuar 4x16mm<sup>2</sup>** do qe

vjen nga gabina elektrike deri te stylla e ndricuesit sipas projektit.

-(Nr Analizes 4.142/1.1) **F.V.kabllo kontrolli Cu te armuar, ne**

**toke, 4x1.5 mm<sup>2</sup>** do te konsistoje ne : Blerjen e kabllit dhe shtrirjen e

lidhjen e tij sipas projektit.

-(Nr Analizes 4.133/3.5) **F.V.ne** **toke kabllo Al fuqie  $\div 1000V$ , me izolim gome e mbulese plastmasi, te armuar,  $4 \times 10 \text{mm}^2$**  do te konsistoje ne : Blerjen e kabllit dhe shtrirjen e lidhjen e tij sipas projektit.

-(Nr Analizes 3.182/a) **Shtrese rere 10 cm** do te konsistoje ne : Blerjen , transportin dhe shtrimin e reres ne kanal.

-(Nr Analizes 3.654) **F.V tub plasmasi O 100 mm** do te konsistoje ne : Blerjen e tubit dhe muftave dhe montimin e tij ne objekt.

-(Nr Analizes 2.490/1a) **F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A** do te konsistoje ne : Blerjen e automatit dhe montimin e tij ne objekt.

-(Nr Analizes 3.240) **Beton bazament shtylle beton C16/20** do te konsistoje ne : Blerjen e materialeve si zhavor e cemento dhe pergatithen e betonit dhe hedhjen ne veper.

pergatitjen e tyre dhe montimin e tyre ne bazamentin e shtylles ndricimit.

-(Nr Analizes).An) **F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement** do te konsistoje ne : Blerjen e kuadrit komandimit komplet dhe montimin e tij ne veper.

-(Nr Analizes 2.a-93) **Percjelles togezimi bakri CU.S=35mm i zhveshur** do te perdoret per togzimin e shtylles te vendoset ne cdo shtylle. konsistoje ne : Blerjen e percjellesit dhe montimin e tij ne elektrodas e tokezimit dhe kuadrin elektrik.

Nnga shtylla e pare deri te shtylla e fundit do vendoset nje fije tel  $4 \text{mm}^2$  te lidhura ne seri me njera tjetren qe togzimi te jete sa me afer zeros.Ne rruge do te vendosen 25 shtylla.

Shuma e Fuqis qe kerkohet  
 $P=9 \text{ KW}$  ,Fuqia qe istalohet  $=7 \text{ KW}$ .

**Ing:**

**Kleodian BIXI**

**Nazmi TANUSHI**

**R A P O R T**

**I**

**VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER**

**RIKONSTRUKSIONIN**

**E RRUGES ALI CAUSHI DHE SHESHEVE TE**

**PALLATEVE 108/3 – 108/12**

**LAGJA SYRJA DYLGJERI,NJESIA ADMINISTRATIVE Nr.3**

**BASHKIA ELBASAN**

Qellimi i këtij projekti është që kësaj rruge ti jepet një dimension të ri gjatë rikonstruksionit, si zgjerimi i saj, vendosja e ndricimit, ndertimin e shtresave të rruges, shtimin e gjelbrimit dhe që do të mundesojë dhe do të përmirësojë në mënyrë të dukshme jetesën e banorëve. Vetë zona ku shtrihet kjo rrugë do të marrin një tjetër pamje e cila ka të bëjë me përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe të banimit, rritjen e cilësisë së ajrit, uljen e zhurmave, vendosjen e sinjalistikës dhe përmirësimin e transportit, përmirësimin e largimit të ujërave të bardha, eliminimin e gropave dhe të dherave në trungun e rrugës etj.

### **BAZA LIGJORE KU MBESHTETET VEPRIMTARIA E PROJEKTIT**

1. Ligji 8652 datë 31. 07. 2000” Për organizimin dhe funksionimin e organeve të qeverisjes vendore i ndryshuar. ,
2. V.K.M. nr. 444 datë 05.09.1994 për “ Tarifat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudit të veprave të ndertimit”
3. Ligji Nr. 8405 , datë 17. 09. 1998 “ Për Urbanistikën ” me ndryshimet e tij .
4. Ligji nr 10431 datë 09.06.2011 “ Për Mbrotjtjen e Mjedisit”
5. Ligji 10440 datë 15.04.2010 “ Përvlerësimin e ndikimit në Mjedis”
6. VKM nr 453 dt. 12/09/2002 “ Për normat e shkarkimit në ajër në Republikën e Shqipërisë”
7. VKM nr 103 dt. 31/03/2003 “ Për monitorimin në mjedis në Republikën e Shqipërisë”
8. VKM nr 249 dt. 24/04/2003 “ Për dokumentacionin për leje mjedisore dhe të elementeve të Lejeve Mjedisore”
9. VKM nr 268 dt.24/04/2003 “ Për caktimin e specialistëve për VNM dhe auditimin mjedisor”
10. Ligji nr 10137 dt 11.05.2009 “ Për substancat dhe parametrat kimik”
11. Ligji nr. 9115 dt. 24/07/2003 “ Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”
12. VKM nr. 177 dt. 31/05/2005 “ Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngjave dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritese”

Projekti zbatohet gjithashtu në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të funksionimit të qeverisjes vendore

Duhet thene qe ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte i hartuar per te gjithë zonen ku shtrihen aksi i rruges dhe qe i vjen ne ndihme nje popullsie relativisht e madhe te bashkise se Elbasanit. Kjo lidhet me kushtet e njejta gjeo-mjedisore qe ka zona ku shtrihen ndertimet qe perfitojne nga rikonstrukcioni i saj.

## **KARAKTERISTIKAT KLIMATIKE**

**Temperatura e ajrit**– Fusha e Elbasanit dhe zona perreth ben pjese ne brezin e klimes mesdhetare dhe dallohet per tipare me te shprehura mesdhetare e cila karakterizohet nga vera e nxehte dhe e thate me shkelqim te madh te diellit dhe dimer i bute dhe me reshje mesatare. Temperatura mesatare vjetore lekundet nga 16°C-17°C

**Rreshjetatmostferike**-Rreshjet ne qytetin e Elbasanit dhe zona perreth kane regjim kohor shume te crregullt, ato jane perqendruar kryesisht ne gjysmen e ftohte te vitit, sasia mesatare e tyre arrin deri ne 960-980mm/vit. Vera eshte e thate dhe shpesh nuk bie shi per jave te tera.

**Bora** - Ne vendin tone, ne periudhen e ftohte te vitit, nje sasi e konsiderueshme e reshjeve vjen prej bores. Kjo veçori eshte me e theksuar ne zonen malore ku bora eshte nje dukuri e zakonshme. Ne zonen ne studim bora vrojtohet rralle dhe mund te konsiderohet si dukuri e jashtezakonshme

**Lageshtia e ajrit** – Muajt me te lagesht ne qytetin e Elbasanit dhe zonat perreth jane nentori dhe janari kurse me te thate korriku dhe gushti. Nderkaq vlerat me te uleta e lageshtires relative vrojtohen ne muajin Korrik dhe Gusht, pikerisht kur mbi rajonet e Mesdheut verehet nje qendrueshmeria anticiklonare e theksuar. Ecuria ditore e lageshtires relative eshte e kundert me ate te temperaturese ajrit. Ne oret e para te mengjesit realizohen vlerat me te larta kurse ne oret e mesdites (paraose pas mesdites) vlerat me te uleta.

**Era** – Ererat fryjne ne drejtime te ndryshme por gjate dimrit mbizoteron era e jugut e cila sjell dhe rreshje te medha, ndersa gjate veres era fryn nga veriu dhe veriu dhe veriperendimi. Shpejtesia e eres ne territorin e zones ne studim ashtu si ne te gjithë vendin tone, eshte ne vartesi te periudhes se vitit. Vlerat me te medha te tyre vrojtohen ne stinen e dimrit kur veprimtaria ciklonare eshte e theksuar.

**Stuhite** - Stuhite qe per vendin tone jane te shumta dhe ndodhin ne te gjithë stinet e vitit, shpesh shoqerohen me breshër. Me shume dite me breshër ka ne muajt e dimrit dhe gjysmen e vjeshtes dhe ne gjysmen e pare te pranveres. Elbasani dhe zonat perreth gjate vitit ka 8 dite me breshëri. Si rregull, zgjatja e breshërit eshte 3 deri 5 minuta. Ne zonen ne studim, breshëri vrojtohet ne çdo kohe te vitit por me shume ne periudhen e ftohte te vitit. Gjate muajit Janar pothuajse vrojtohet mesatarisht nje dite me breshëri, Ne periudhen e ngrohte te vitit numri i diteve me breshër eshte i paket.

Stuhite ne zonen ne studim mund te ndodhin ne çdo muaj, kjo tregon karakterin mesdhetar qe ka klima e zones tone. Ne thellesi te territorit te Gadishullit Ballkanik gjate periudhes se ftohte te vitit (dimrit) stuhite pothuajse nuk ndodhin fare, kjo shpjegohet me karakterin kontinental te klimesme ate rajon.

**Flora dhe Fauna** - Rrethi i Elbasanit dallohet per disa lloje bimesh dhe kafshesh sidomos ne pjeset bregdetare dhe fushore. Takohen disa lloj kafshesh si urithi, çakalli, nusja e lales, dhelpa,shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje te ndryshem zvarranikesh e gjarperinj. Etj.Rrethi i Elbasanit ben pjese ne brezin e shkurreve dhe te pyjeve mesdhetare. Shkuret perbehen nga nenkati i makies, ku rriten shkurre me gjelberim te perhershem si mareja, shqopa,geshtenja. Ne kete nenkat bimor rriten edhe disa drure te larte si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger qe ne disa raste formojne pyje te vegjel.

**Objektet arkeologjike dhe kulturore** - Ne kete zone ku do ti nenshtrohet rikonstruksionit te rruges te brendeshme nuk takohen as objekte fetare dhe as objekte te cilat futen ne fondin e trashegimise kulturore dhe arkeologjike. Gjate gjithë konsultimit me literaturen dhe studime te kryera per kete zone, nuk jane gjetur objekte arkeologjike ose kulturore dhe nuk ka te dhena qe mund te ekzistojne. Sipas ligjit te Shqiperise,objektet fetare trajtohen si prone private, perveç kur ato zoterohen nga shteti.

**Cilesia e ajrit dhe normat e tij** -Ndotesit primare te prodhuar nga trafiku rrugor jane ato qe emetohen direkt ne atmosfere nga tubat e shkarkimit te automjeteve, te cilet jane dioksidi i karbonit ( $CO_2$ ), monoksidi i karbonit ( $CO$ ), hidrokarburet ( $HC$ ), oksidet e azotit ( $NO_x$ ), oksidet e sulfurit ( $SO_x$ ), dhe grimcat.Dioksidi i karbonit ( $CO_2$ ) eshte gaz i ngrohjes globale dhe produkt natyral i djegies se benzenes dhe naftes. Nuk ka impakt te drejtperdrejte ne shendetin e popullesise rrethuese.Perqendrimet e monoksidit te karbonit ( $CO$ ) reduktojne aftesine metabolizuese te njeriut.Simptomat jane pergjumja dhe dhimbja e kokes. Per perqendrimet mbi 0.1 % mund te shkaktoje vdekje.Keto nivele nuk shkaktohen nga trafiku dhe perqendrimet ne hapsirat rurale jane probleme te rralla. Njerezit e ekspozuar ne  $CO$  mund te sherohen duke u larguar nga vendi i ndotur.Monoksidi i karbonit ( $CO$ ) eshte problem i veçante per tregtaret, per ata qe punojne per nje kohe te gjate ne ane te rrugeve te mbi populluara, te cilat jane te rrethuara me objekte duke krijuar efektin kanion, i cili perqendron ndotesit ne lartesi te vogla.Ndotesit sekondare krijohen nga dy ndotes primare,  $HC$  dhe  $NO_x$  dhe si rezultat i reaksioneve fotokimike prodhohen oksidues si ozoni ( $O_3$ ), peroksacetil nitrati ( $PAN$ ) dhe peroksibenzol nitrati ( $PBN$ ). Keto oksidues ne perqendrimet te larta mund te kene nje efekt te gjere ne shendet dhe vegjetacion. Standartet e cilesise se ajrit ne Shqiperi tregohen ne tabelat me poshte.

## Tabela . Standartet ne Shqiperi per cilesine e ajrit ne hapesirat urbane

(Ne kuptim te ketij vendimi ne normat e cilesise se ajrit nuk perfshihen normat e mjediseve te brendshme te banimit dhe te punes).

| Nr.       | NDOTESI                                           | VLERAT E                    | TIPI I            |
|-----------|---------------------------------------------------|-----------------------------|-------------------|
| Rendor    |                                                   | STANDARDIT                  | STANDARDIT        |
| <b>1.</b> | <b>Monoksidkarboni (CO)</b>                       |                             |                   |
|           | Mesatare 24-oresh****                             | 2 mg/m <sup>3</sup>         | Primar *          |
|           | Mesatare 8-oresh                                  | 10 mg/m <sup>3</sup>        | Primar            |
|           | Mesatare 1-oresh                                  | 40 mg/m <sup>3</sup>        | Primar            |
| <b>2.</b> | <b>Bioksid azoti (NO<sub>2</sub>)</b>             |                             |                   |
|           | Mesatare vjetore arithmetike                      | 60 µg/m <sup>3</sup>        | Primar & Sekondar |
| **        |                                                   |                             |                   |
|           | Mesatare 4-oresh                                  | 95 µg/m <sup>3</sup>        | Sekondar          |
|           | Mesatare 1-oresh                                  | 250 µg/m <sup>3</sup>       | Primar            |
| <b>4.</b> | <b>Plumb (Pb)</b>                                 |                             |                   |
|           | Mesatare vjetore arithmetike                      | 1.0 µg/m <sup>3</sup>       | Primar & Sekondar |
|           | Mesatare 24-oresh****                             | 1.5 µg/m <sup>3</sup>       | Primar & Sekondar |
| <b>5.</b> | <b>Lende e grimcuar edepozituar (LGD)</b>         |                             |                   |
|           | Mesatare vjetore arithmetike                      | 350 mg/m <sup>2</sup> /dite | Primar & Sekondar |
| <b>6.</b> | <b>Lende e grimcuar pezull (LGP)</b>              | 140 µg/m <sup>3</sup>       |                   |
|           | Mesatare vjetore arithmetike                      |                             | Primar & Sekondar |
|           | Mesatare 24-oresh                                 | 250 µg/m <sup>3</sup>       | Primar            |
|           | & Sekondar                                        |                             |                   |
| <b>7.</b> | <b>Lende e grimcuar&lt; 10 mikrometer (PM 10)</b> |                             |                   |
|           | Mesatare vjetore arithmetike                      | 60 µg/m <sup>3</sup>        | Primar & Sekondar |
|           | Mesatare 24-oresh                                 | 150 µg/m <sup>3</sup>       | Primar & Sekondar |

## 8. Lende e grimcuar < 2.5 mikrometer (PM 2.5)

|                              |                      |                   |
|------------------------------|----------------------|-------------------|
| Mesatare vjetore arithmetike | 15 µg/m <sup>3</sup> | Primar & Sekondar |
| Mesatare 24-oreshe           | 66 µg/m <sup>3</sup> | Primar & Sekondar |

## 9. Bioksid squfuri (SO<sub>2</sub>)

|                              |                       |          |
|------------------------------|-----------------------|----------|
| Mesatare vjetore arithmetike | 60 µg/m <sup>3</sup>  | Primar   |
| Mesatare vjetore arithmetike | 35 µg/m <sup>3</sup>  | Sekondar |
| Mesatare 24-oreshe           | 120 µg/m <sup>3</sup> | Primar   |

**Standardet primare** janë kufij që shërbejnë për të mbrojtur shëndetin e popullatave "te ndjeshme" si azmatiket, fëmijet dhe pleqtë.

**\*\*Standardet sekondare** janë kufij që shërbejnë për të mbrojtur mireqenien publike, duke përfshirë mbrojtjen kundrejt uljes së pamjes, demtimit të kafsheve, të mbjellave, bimëve dhe ndërtesave.

**Zhurmat** - Pranimi i një niveli të caktuar zhurmash varion nga lagjet, individët dhe periudha e ditës. Zhurma influencon në të gjitha aktivitetet, por problem të veçantë përbën për zonat e ndjeshme siç janë spitalet. Hapesirat e banuara ndikohen zakonisht gjatë orëve të natës dhe në pasditen e vonë. Zhurma bashkë me trafikun rrugor zakonisht konsiderohet të jetë pak a shumë në një nivel konstant, ndonëse kjo ndoshta nuk është një paraqitje e drejtë e zhurmave të lindura nga trafiku aktual në seksionin rrugor që përfshin projektin. Zakonisht si njësi për të matur zhurmat përdoret decibeli (dB). Diferenca më e vogël e nivelit të zhurmës që arrijn ta perceptojë veshi i njeriut është afërsisht 3 dB. "A" është një koeficient me anë të të cilit, frekuencave të larta u jepet një ngarkesë ekstra. Një matje e niveleve të zhurmave është *Leq*. *Leq* është niveli ekuivalent konstant, i cili me kalimin e kohës përmban të njëjtën sasi të energjisë së tingullit sa është niveli i ndryshueshëm i zhurmave të trafikut. Standartet e zhurmave të ambjentëve të ndryshme janë zhvilluar. Bashkimi evropian ka përpunuar vlerat për tipe të ndryshme hapesirash dhe janë të paraqitura në tabelën më poshtë. Këto tregojnë nivelet më të larta të tolerueshme gjatë natës dhe ditës.

## KAPITULLI II

### NDIKIMET NË MJEDIS

Gjate rikonstruksionit të rruges do të vihen re një sere ndikimesh në mjedis. Këto ndikime do të jenë direkte, si erozioni i tokës gjatë ndërtimit, zhurma dhe pluhuri gjatë ndërtimit si dhe gjate funksionimit, ose indirekte si ndryshimi i detyruar i përdorimit të tokës dhe zhvillimi ekonomik.

#### Ndikimet gjate fazes së punimeve

##### Erozioni i tokës

Si rezultat i operacioneve të çarjeve, të mbushjeve gjatë shtrëngatave të shiut, mund të shkaktohet turbiditet në ujë sipërfaqësor. Këto mund të krijohen përkohësisht gjatë ditëve me shira të fuqishëm si dhe perroska të vogla.

Në tabelat më poshtë paraqitet analiza matricore ndikimeve.

**Tabela a. Ndikimet në tokë**

NDIKIMET NË TOKË IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE VLERËSIMI I NDIKIMEVE

|                                   | Mungesë | Prani      |
|-----------------------------------|---------|------------|
| Erozioni i tokës                  | X (1)   | 0          |
| Pjerrësi të paqëndrueshme         | X (1)   | 0          |
| Bordurat me materiale të dëmtuara | X (2)   | 0          |
| Kompaktësia e tokës               |         | 0          |
| Ndotja e tokës nga                |         |            |
| derdhjet e automjeteve            | X (5)   | -1         |
| Skarifikimi dhe gërryerja         | X (6)   | 0          |
| <b>TOTALI</b>                     |         | <b>- 1</b> |

☐ Zgjidhjet dhe shpjegimet për tabelën:

**(1)** Kjo është për shkak të nevojës për të zgjeruar rruget, si pasoje e problemeve të sistemit të tokës sipërfaqesore.

**(2)** Nuk ka impakte nëse përdoren teknikat e duhura të menaxhimit të shtresës së sipërme të tokës. Megjithatë toka e gërmuar duhet të ripërdoret nëmaksimum për të krijuar mbushje, duke reduktuar impaktet në vendet e tjera.

**(3)** Në rast të kundërt duhet të konsiderojmë që pikat inerte të tokës do të shtyhen për në sipërfaqe. Ato nuk janë të përdorshme as për breza të ngushtë vegjetacioni, as për qëllime kultivimi dhe përbëjnë një shpërdorim që gjeneron ndikime negative.

**(4)** Toka e gërmuar mund të ngjeshet nga mjetet e rënda ose buldozerët. Përveç kësaj alternative, mjetet do të detyrohen të ecin kryesisht në seksione paralele. Nëse nuk parandalohet si duhet, ky impakt mund të bëhet i rëndësishëm.

**(5)** Ky është rasti i substancave ndotëse (vaj, benzinë, graso, etj), të cilat vijnë nga mjetet e përdorura gjatë punimeve të ndërtimit dhe operimeve.

**(6)** Në këtë rast impaktet e përmendura nuk priten nga materialet kryesore që do të përdoren nga skarifikimi i rrugëve dhe nga materialet e ardhura. Materialet e teperta mund të përdoren për ndërtimin e seksioneve të thjeshta.

Në ndonjë rast mund të shkaktohet erozion në zonat dhe segmentet që janë nën rikonstrukcion dhe bllokimin e kanalizimeve dhe të tubave të kullimit. Ky rrezik mund të zvogëlohet me anë të kontrollit të operacioneve specifike në vendodhje nga autoritetet e ndërmarrjeve të ujësjellsit dhe kanalizimeve. Operacione specifike mund të konsiderohen gërmimet pranë objekteve ekzistuese të drenazheve dhe të kanalizimeve, lidhje të reja tubacionesh të drenazheve dhe kanalizimeve me rrjetin ekzistues etj. Reduktimi i këtyre lloj aktiviteteve gjatë rasteve me kohë të keqe, do të zvogëlojë rrezikun e bllokimit/dëmtimit të rrjeteve operacionale. Ndotësit kryesorë të prodhuar nga automjetet janë: grimcat solide, të cilat vijnë nga korrozioni, metalet, gomat, sipërfaqja e rrugës, etj, plumbi, kadmiumi dhe komponimet organike (graso, vajrat lubrifikantë etj.). Këto efekte janë të rëndësishme në pikat e emisioneve (pikate shkarkimit të rrjedhjeve

#### **Tabela b Ndikimet në ujë nga emisionet**

NDIKIMET NË UJË IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE  
VLERËSIMI I

NDIKIMEVE

**Mungesë**

**Prani**

Ndotja e ujit nga

rrjedhjet rrugore që

përmbajnë

plumb,zink,pluhurdhe

|                             |       |           |   |
|-----------------------------|-------|-----------|---|
| substancia të tjera ndotëse | X (2) | X (1) (2) | - |
| 1                           |       |           |   |

Impaktet sekondare të

Ujit sipërfaqësor dhe

Nëntokësor të ndotur në

kufijtë e rrugeve

|       |   |
|-------|---|
| X (3) | 0 |
|-------|---|

Modifikimi i sistemin e

|             |       |       |   |
|-------------|-------|-------|---|
| drenazhimit | X (4) | X (4) | 0 |
|-------------|-------|-------|---|

|               |  |  |            |
|---------------|--|--|------------|
| <b>TOTALI</b> |  |  | <b>- 1</b> |
|---------------|--|--|------------|

☐Zgjidhjet dhe shpjegimet për tabelën:

**(1)** Pluhuri nuk mund të eliminohet ndonëse shkakton impakt të ulët.

**(2)** Prania ose mungesa e plumbit, zinkut dhe ndotësve të tjerë varen nga përdorimi korrekt i karburantëve pa plumb dhe nga mirëmbajtja e duhur e motorit. Firot aksidentale (vaj,benzinë dhe lëndë toksike nga serbatorët) mund të përfaqësojnë ndotësit më tërrezikshëm për ujrat.Për shkak të vjetërsisë së automjeteve, mendohet se një përdorim i karburanteve pa plumb mund ta mbajë këtë ndikim për shumë kohë në të njëjtin nivel.

**(3)** Kjo lloj ndotjeje gjenerohet nga kontakti i ujit të ndotur të rrugeve, kur arrin ujrarnëntokësore, ku bashkohet me ujin e përdorur nga popullsia. Evitimi i kësaj arrihet duke ndërtuar kanale përgjatë aksit të rruges për të mbledhur ujin e ndotur.

**(4)** Ndërtimi i rrugës mund të interferojë në sistemin ekzistues të drenazhimit dhe kanalizimit.

## **Cilësia e ajrit**

Era dhe trafiku do të shkaktojë ngritjen e pluhurave, veçanërisht në stinët e thata. Për të parandaluar këto sipërfaqe me pluhur, ato duhen lagur rregullisht.

## **Rrethana të papërshtatshme**

Rrethana të papërshtatshme dhe mbyllja e zonave të huazuara për materialet e përdorura për rikonstrukcion, mund të shkaktojë në dëmtim të mjedisit natyral dhe pamje të papëlqyeshme. Hedhja e mbetjeve kryesisht të atyre inerte të cilat do të krijohen nga prishja e disa mureve rrethuese duhet të sistemohen në vende të përshtatshme të përcaktuara nga Bashkia e Elbasanit. Për këtë do të kërket kontraktori të përgatitë një plan për magazinimin e perkohshëm të këtyre materialeve. Ky plan duhet të përgatitet nga kontraktuesi përpara fillimit të aktivitetit. Në këtë plan kontraktuesi duhet të përcaktojë qartë sasinë e materialit që do të magazinohet, të përkohësisht dhe cila pjesë e tij do të transportohet në destinacionin final të sistemuar. Detajimet e këtij plani duhet të specifikojnë në gjithashtu natyrën e materialit që do të sistemohet dhe origjinën e tij. Përshembull: gjurmime në kanale, shtresa e sipërme e tokës, shkrifërim i sipërfaqe ekzistuese të rrugës etj. Ky plan duhet të rishikohet fillimisht nga supervisor i kontratës dhe më pas të adresohet për miratim pranë Bashkisë së Elbasanit. Kontraktuesit duhet të përdorin për sistemim të tepër të materialeve vendin e depozitimit të përcaktuar nga pushteti lokal. Materialet inerte sjellin ndotje për njerëzit dhe degradim të mjedisit. Kontraktuesi duhet të veprojë dhe të mbyllë këto zona pa rrezikuar kushtet mjedisore.

## **Ndikimet në mjedisin njerëzor**

a. ka ndikim negativ në prishjen e mureve rrethuese edhe gjatë ndërtimit të aksit të rrugës.

## **b. Ndikimet në trashëgiminë kulturore**

Ashtu siç është paraqitur më lart në zonën ku do të zbatohet projekti nuk ka objekte fetare, kisha, xhamia, prandaj edhe nuk ka ndikime negative në trashëgiminë kulturore. Në tabelën paraqitet analiza matricore e këtyre ndikimeve.

## **Ndikimet në trashëgiminë kulturore**

| NDIKIMET NË TRASHËGIMINË | IDENTIFIKIMI I | VLERËSIMI I |
|--------------------------|----------------|-------------|
| KULTURORE                | NDIKIMEVE      | NDIKIMEVE   |
| <b>Mungesë</b>           | <b>Prani</b>   |             |

Dëme të

monumenteve me

vlera arkeologjike

X (1)

0

TOTALI

0

☐ Zgjidhjet dhe shpjegimet për tabelën.

**(1)** Siç është specifikuar edhe më lart, nuk janë identifikuar zona me vlera kulturore dhe

historike.

### **Shërbimet publike**

Në parim shërbimet publike kryesore do të preken nga projekti. Projekti do të përmirësojë sistemin e furnizimit me ujë, sistemin e kanalizimit, do të rrisë mbrojtjen e linjave elektrike dhe telefonike. Përkohësisht gjatë periudhës së ndërtimit, këto shërbime mund të krijojnë probleme tek përdoruesit. Këto probleme mund të ndikojnë më shumë tek përdoruesit rreth aksit të rrugëve gjatë proceseve të lidhjeve të kablllove dhe tubacioneve të reja në rrjetin ekzistues. Në këto raste kontraktues iduhet të përgatisë planveprimin e detajuar përpara çdo hapi të aktivitetit të tij në këtë zonë. Ky plan duhet të parashikojë rregullimin dhe mbrojtjen e të gjitha shërbimeve publike të vendosura në zonën e aktiviteteve si telefon dhe kabllot elektrike, kabllot optike, tubacionet e furnizimit me ujë, ose objekte të tjera që mund të rezultojnë nga kontroll i zonës. Kontraktuesi duhet të koordinojë aktivitetet me sipërmarrjet përgjegjëse që kanë në pronësi (rekuizitët) këto rrjete si Telekomi, KESH dhe Ndërmarrja e Furnizimit me Ujë, në mënyrë që të reduktojnë në maksimum dëmet dhe kohën e realizimit të lidhjeve me rrjetin ekzistues. Ky plan duhet të rishikohet fillimisht nga supervizori i kontratës dhe duhet të fillojë implementimin pas miratimit final të punëdhënësit.

## HARTA GJEOMJEDISORE E ZONES



### KAPITULLI III

#### PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

Termat e Referencës të projektit tregojnë nevojën e përgatitjes së planimetrisë së zones me të gjitha komponentët duke përfshirë rikonstruksionin dhe zgjerimin errugesj, trotualet, brezin e gjelberimit, ndricimin etj. Projektuesi gjithashtu do të përgatise preventivin e kostos për të gjitha seksionet.

## **Studimi arkeologjik**

Një studim i detajuar arkeologjik i projektit final të zgjedhur, do të ndërmerret në paralel me projektin final dhe çdo relike arkeologjike e gjetur do të lëvizet dhe konservohet përpara fillimit të ndërtimeve. Në rastet kur lokalizohet një zbulim i rëndësishëm, siç janë reliket e mureve ose ndonjë lloj tjetër, puna duhet të ndalohet menjëherë dhe kontraktori duhet të njoftojë menaxherin e projektit dhe punëdhënësin, të cilët duhet t'i kushtojnë vëmendje maksimale në identifikimin dhe në konservimin e objekteve me vlerë.

## **Masat për kampet e ndërtimit dhe për objektet e ngjashme**

Specifikimet në kontratën e projektit duhet të përcaktojnë që restaurimi i objekteve, të cilat strehojnë personelin e ndërtimit, ruajtjen e pajisjeve dhe mjeteve, kampet e punës dhe objekte të ngjashme, duhet të drejtohen dhe të aprovohen nga supervizori. Kjo aplikohet tek të gjitha objektet e këtij lloji duke përfshirë edhe ato private. Të gjitha pajisjet e ndërtimit duhet të liçensohen sipas kërkesave lokale.

## **KAPITULLI IV**

### **IV. MONITORIMI**

Programi i monitorimit mjedisor është i inkorporuar në projekt dhe përfshin inspektime dhe raportime zone rutinë.

#### **Monitorimi i tokës dhe erozionit**

Gjatë rikonstruksionit, eksperti mjedisor do të inspektojë të gjitha punimet javore, për t'u siguruar që masat për erozionin e tokës janë implementuar siç duhet. Nëse kërkesat nuk janë implementuar, ai do të njoftojë menjëherë kontraktuesin dhe supervizori duhet të jetë i përgjegjshëm që të merren masat e duhura dhe korrekte. Në rast se ai gjen shenja erozioni aktuale ose potenciale, ai duhet të njoftojë menjëherë përgjegjësin e zyrave të Pushtetit Lokal .

#### **Monitorimi i cilësisë së ujit**

Monitorimi para rikonstruksionit, për të vendosur kushtet fillestare, duhet bërë në zonat që ka vendosur supervizori. Monitorimi fillestar i cilësisë së ujit rekomandohet në zonat me burimet më të mëdha të ndotjes potenciale të ujit (kampet e ndërtimit dhe burime të tjera të rrjedhjeve të rëndësishme dhe prodhimit të ndotjeve të lëngeta). Rekomandohet matja e grimcave në suspensë [MES], kërkesës biologjike për oksigjen [BOD], konduktiviteti dhe koliformët fekale dhe nivelet e vajit dhe grasos. Frekuenca e monitorimit të cilësisë së ujit do të vendoset duke u mbështetur ne metodika të miratuara dhe të përcaktuara në legjislacionin mjedisor shqiptar.

### **Monitorimi i cilësisë së ajrit**

Monitorimi para rikonstruksionit, për të vendodur kushtet fillestare, duhet bërë në zonat që ka vendosur supervizori, përbrenda segmenteve të rehabilitimit me gjatësi të mjaftueshme për të garantuar këtë lloj monitorimi. Monitorimi i ajrit do të kryhet kryesisht për Lenden e Ngurte pezull LNP, Lenden e ngurte të depozituar LGD, pluhurat PM10 dhe PM2.5 me aparatura për ndotësit e ajrit, e rastet kur do tekerkohet mund të kryhet dhe monitorimi i gazeve me aparatura të percaktuara.

### **Monitorimi i zhurmave**

Kontratat e ndërtimit do të kërkojnë monitorim me aparatura Suonometra , një herë përpara fillimit të ndërtimeve, për të vendosur drejtimet kryesore të impakteve që do të maten. Monitorimi fillestar i zhurmave do të kërkohet vetëm aty ku kohëzgjatja e potencialit të impakteve dhe receptorët e ndjeshëm të justifikojë këtë monitorim. Monitorimi me aparate dhe nga institucione të specializuara duhet të bëhet sipas metodikave të standartizuara dhe në frekuenca të percaktuara nga legjislacioni në fuqi.

### **Raportimi**

Pushteti Lokal duhet të përgatise një raport vjetor duke detajuar rezultatet e programit monitorues.

### **Forcimi institucional**

